




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Në mbështetje të nenit 37 paragrafi 1.18, nenin 38 paragrafi 1.4, nenin 46 paragrafi 2.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01.Nr.85/2014 të datës 25.11.2014, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 02.12.2014, merr:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PROJEKTIT TË MANIFESTIMIT MULTIKULTUROR
"FLAKA E JANARIT" 2015

1. Me këtë vendim aprohet Projekti i Manifestimit Multikulturor "Flaka e Janarit" 2015 dhe Rekomandimet si në vijim:
 - 1.1 Të bëhet shpallja publike për bartjen e shtyllave të aktivitetit sipas fizionomisë së Manifestimit,
 - 1.2 Shfaqjet Teatrale të mbahen me karakter jo garues gjatë muajit Janar, përderisa Festivali i Dramës Shqipe me karakter garues të mbahet në muajin Maji i kombinuar me Xhaz festival,
 - 1.3 Manifestimi të ketë gjithë përfshirje të bartësve në secilin aktivitet veç e veç.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekti i Manifestimit Multikulturor "Flaka e Janarit" 2015.
3. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Kryetari i Komunës dhe Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesja e KK-Gjilan.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16-134640
Gjilan, më 02.12.2014

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi